



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo - Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština – Assembly*

---

**Legjislatura IV**

**Sesioni pranveror**

Komisioni për Legjislacion

Mbledhja nr. 35

Prishtinë, më 30 janar 2012, në orën 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla C- 203

**PROCESVERBAL**

I mbledhjes së Komisionit për Legjislacion

**Në mbledhje morën pjesë:** Behar Selimi, Mufera Şinik, Haki Demolli, Halit Krasniqi, Arsim Bajrami, Albulena Haxhiu, Ardian Gjini, Amir Ahmeti, Armend Zemaj dhe Jasmina Zhivkoviq.

**Mungoi:** Arben Gashi.

**Të ftuar dhe pjesëmarrës të tjerë:** Lumnije Murati- ZPRK, Petrit Hysaj – OSBE, Artan Canhasi – EULEX dhe Isuf Zenaj – KDI.

**Nga stafi i Komisionit për Legjislacion:** Idriz Tahiri, Fehmi Hyseni dhe Visar Krasniqi.

**Mbledhjen e kryesoi:** Behar Selimi, nënkryetar i Komisionit.

**Rend i ditës:**

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Raporti i punës së Komisionit për vitin 2011;
3. Shqyrtimi dhe miratimi i planit të punës së Komisionit për vitin 2012;
4. Shqyrtimi i raportit me amendamente i Komisionit Funkcional në Projektligjin Nr. 04/L-062 për fshatin Hoçë e Madhe;
5. Të ndryshme.

**1. Miratimi i rendit të ditës**

**Kryesuesi** propozoi që pika 4 të hiqet nga rendi ditës.

*Rendi ditës u miratua me ndryshime.*

## **2. Raporti i punës së Komisionit për vitin 2011**

*Kryesuesi konstatoi se Komisioni për Legjislacion lidhur me këtë pikë njëzëri nxori këtë*

### **Përfundim**

*Miratohet raporti i punës së Komisionit për vitin 2011, pa vërejtje.*

## **3. Shqyrtimi dhe miratimi i planit të punës së Komisionit për vitin 2012**

**Kryesuesi** paraqiti për shqyrtim dhe miratim planin e punës së Komisionit për vitin 2012 dhe kërkoi nga anëtarët nëse kanë vërejtje t'i paraqesin.

**Arsim Bajrami** – Tha se plani është korrekt, por duhet të përfshihen edhe disa ligje që pritet t'i procedohen Komisionit, si projektligji për amendamentimin e ligjit zgjedhor, PL për zgjedhjen e Presidentit dhe PL për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit për Presidentin.

**Armend Zemaj** - Tha se është në kompetencë të Komisionit edhe mbikëqyrjen e zbatueshmërisë së ligjeve dhe kjo është e një rëndësie të veçantë dhe nuk mund ta anashkalojmë. Prandaj edhe duhet të përfshihet në planin e punës për vitin 2012, se cilin ligj do të ta monitorojmë, vendosim në Komision. Në vazhdim tha se edhe në mbledhjen e kaluar kemi diskutuar që, si Komision, ta marrim për obligim rihartimin e ligjit për të drejtat dhe përgjegjësitë e deputetit, andaj edhe kjo duhet të përfshihet në këtë plan.

*Kryesuesi konstatoi se Komisioni për Legjislacion lidhur me këtë pikë njëzëri nxori këtë*

### **Përfundim**

*Miratohet plani i punës së Komisionit për vitin 2012, me sugjerimet e dhëna.*

## **4. Të ndryshme**

Lidhur me këtë pikë nuk kishte diskutime.

Mbledhja përfundoi në orën 11:35.

E përgatiti:  
Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Nënkryetari i Komisionit

---

Behar Selimi